



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE/PRANIMIN NË SHËRBIM CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Lloji i diplomës “Gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/gjuhë letërsi/ gjuhë e huaj”

Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr.243 datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

- 1 (një) Specialist, në Sektorin e Marrëdhënies me Jashtë dhe Publikun në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënies me Jashtë - Kategoria e pagës III-b

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakat, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LEVIZJE PARALELE: **29.01.2018**

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL: **03.02.2018**

Përshkrimi i punës:

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Ndjek dhe zbaton detyrat për organizimin e aktiviteteve për Autoritetin e Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me autoritetet e tjera analoge, organizmat ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit si edhe me partner të tjerë në funksion të fuqizimit të bashkëpunimit.
- Publikon dhe përditëson ëeb-faqen e institucionit me të gjitha informacionet zyrtare, buletinet e ndryshme javore, mujore etj, me qëllim transaprecën ndaj publikut.
- Bën pritje me qytetarët, administron portalin e ankesave online, si dhe ndjek ecurinë e kthimit të përgjigje për të interesuarit.
- Krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesvave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar.
- Krijon dhe mban kontakt të vazhdueshëm me partnerë brenda dhe jashtë vendit në shkëmbim të informacionit dhe praktikave më të mira në lidhje me zhvillimet në fushën e medias elektronike.
- Ndjek zbatimin e aktiviteteve në kuadër të projekteve të AMA-s me mbështetje ndërkombëtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- g) Mban marrëdhënie periodike me median e shkruar dhe audiovizive. Ndjek dhe monitoron këto media. Vë titullarin në dijeni në rast se ka kronika ose shkrime që lidhen me punën e institucionit.
- h) Identifikon, përgatit dhe kryen menaxhimin teknik të projekteve të financuara nga donatorët në fushën e medias, në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë e tjera të institucionit.
- i) Identifikon donatorë potencialë për financimin e projekteve të ndryshme në fushën e medias të përgatitura nga AMA;
- j) Ofron mbështetje mbi hartimin e strategjive në fushën e komunikimit.
- k) Nxit marrëdhënie të reja bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare.
- l) Nxit standardet dhe praktikat me te reja qe përdoren sot ne bote ne lidhje me fushën e mediave

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-b);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në “gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/gjuhë letërsi/ gjuhë e huaj” . Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë një vit eksperiencë pune në nivel ekzekutiv;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokoll – arkiv, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) Fotokopje të diplomës;
- c) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d) fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 29.01.2018.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Në datën. 31.01.2018 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Për kandidatet që aplikojnë nga jashtë sistemit të shërbimit civil



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë kandidatet jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për plotësimin e vendit të lirë.

II.1-Kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në “Gazetari/marketing/shkenca komunikimi/shkenca politike/gjuhë letërsi/ gjuhë e huaj. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë mbi 1 vit eksperiencë pune në profesion.

II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim
- b) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dh) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me postë ose dorazi deri në datën 03.02.2018 në Autoritetin e Mediave Audiovizive.

II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Në datën 06.02.2018, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

II.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

II.6- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të Autoritetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë.